

„Forcimi i kapacitetit institucional të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në rrugën drejt anëtarësimit të saj në SEBQ“

❖ Çfarë ndodhi midis 15 qershorit dhe 14 shtatorit të vitit 2020?

15 ditët e para të tremujorit të katër të projektit ishin pjesë e periudhës së pezullimit, pasi projekti u pezullua midis 1 prillit dhe 30 qershorit për shkak të pandemisë së Kovid-10. Që nga ajo kohë, pesë misione ekspertësh janë organizuar dhe kryer me sukses nga distanca. Këto aktivitete përfshijnë takimin e katërt të Bordit të Menaxhimit të Projektit, i mbajtur gjithashtu në mënyrë virtuale, në fillim të qershorit.



Takim i Bordit të Menaxhimit të Komitetit të Projektit në kushte të „normalitetit të ri“ - video konferencë përmes internetit

Komponenti 1. SHËRBIMET DHE SISTEMET E PAGESAVE

Në tremujorin e katërt të Projektit, u zhvilluan **dy misione virtuale**. Në kuadër të aktivitetit të dytë të këtij komponenti „**Harmonizim i mëtejshëm i kornizës së politikave të shërbimeve të pagesave në BPRM me direktivat dhe rregullativat e BE-së në fushën e shërbimeve të pagesave**“, ekspertë nga banka qendrore e Portugalisë dhe Rumanisë zhvilluan dy misione të ndara.

Në misionin e parë „Prezantimi i shërbimeve më përfaqësuese të pagesave“, temat e diskutuara kishin të bënin kryesisht me kompetencat dhe aktivitetet e bankës qendrore të Portugalisë për kryerjen e mbikëqyrjes, kornizën ligjore dhe rregullore që zbatohet për llogaritë dhe shërbimet e pagesave, krahasimi i tarifave, në veçanti korniza ligjore dhe rregullorja e zbatueshme, si dhe zbatimi dhe menaxhimi i saj.

Gjatë misionit të dytë, eksperti rumun bëri një përmbledhje gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të temave në vijim: përgjegjësitë kryesore të Departamentit të Mbikëqyrjes së Sistemeve të Pagesave; përvojat në aktivitetet komunikuese lidhur me shërbimet e pagesave; përgjegjësitë e bankës qendrore lidhur me Direktivën për Shërbimet Pagesave 2 (PSD2), PSD 2 - korniza e përgjithshme, Standardet Rregullore Teknike (PTS) dhe udhëzimet; përvoja rumune me Zonën e Vetme të Pagesave Evropiane (SEPA) - kërkesat për transferim të kredisë dhe huazim i drejtpërdrejtë në euro (rregullativa (BE) nr. 260/2012); përvoja rumune me organet evropiane gjatë kohës së procesit të pranimit; rregullimi i tarifave të zëvendësimit në transaksionet e pagesave bazuar në kartat e pagesave; RTS për skemat e pagesave me kartë dhe

subjekte për përpunim lidhur me Rregullativën për Tarifat e Zëvendësimit dhe aktivitetet e BPR-së për harmonizimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave me kërkesë ligjore nga fusha e pagesave dhe rekomandimet e dhëna për komunikim me organet e BE-së gjatë procesit të aderimit lidhur me këtë temë.

Komponenti 2. RREGULLORJA BANKARE DHE MBIKËQYRJA

Në aktivitetin e dytë, „Zhvillimi i metodologjisë së brendshme në procesin e përcaktimit të likuiditetit të brendshëm të bankave (ILAAP) dhe integrimi i saj në procesin e vlerësimit mbikëqyrës (SREP)“, është mbajtur një mision virtual me temë për çështjet rregullore lidhur me normën e mbulimit me likuiditet, i udhëhequr nga një ekspert i bankës qendrore të Kroacisë.

Në kuadër të video konferencës dyditore, eksperti bëri një prezantim të hollësishëm lidhur me zbatimin e dy rregullativave të deleguara të BE 2015/61 dhe 2018/1620 për kërkesën për mbulimin e likuiditetit për institucionet e kredisë (në tekstin e mëtejshëm: DA për BPL), duke i theksuar opsionet nacionale të DA-së për BPL-në. Ditën e dytë, eksperti i bankës qendrore të Kroacisë gjithashtu mbajti një prezantim të shkurtër për parametrat shtesë për mbikëqyrjen e likuiditetit që aktualisht janë në fuqi në BE. Para thirrjes së konferencës, përfaqësuesit e BPRMV-së i dërguan pyetjet e tyre për të cilat morën përgjigje gjatë takimit.

Komponenti 3. STATISTIKA E LLOGARIVE FINANCIARE

Në këtë tremujor u mbajt një mision virtual në fillim të qershorit. Ai u drejtua nga ekspertët të Bankës Popullore të Kroacisë (BPK) dhe Banka e Rumanisë (BR).

Gjatë punës intensive pesëditore, duke e përdorur video konferencën, këmbim të e-mailave dhe mënyrave të tjera të bashkëpunimit nga distanca, ekspertët e BPK-së dhe BR-së në bashkëpunim me kolegët nga shteti përfitues vazhduan me punën e tyre në përpilimin e pilot versionit të llogarive financiare të Maqedonisë së Veriut (si për bilancet, ashtu edhe për flukset për një vit, të dhëna tremujore/vjetore). Ata i analizuan kërkesat dhe rekomandimet nga misioni paraprak, të dhënat e përgatitura dhe të dorëzuara nga kolegët e Drejtorisë së Statistikës së BPRMV-së dhe u pajtuan për hapa të ngjashëm drejt përfundimit të rezultateve për aktivitetin „Mbështetje për harmonizimin e mëtejshëm të statistikës së llogarive financiare të BPRMV-së me standardet e SEBQ/BQE“. Në misionin e tretë në kuadër të këtij aktiviteti, ekspertët nga bankat qendrore konkretisht i analizuan burimet e të dhënave, sistemin aktual për përpilim dhe procedurat punës për grumbullim të të dhënave për llogaritë financiare (bilance) të sektorëve: shtet, kompani jofinanciare dhe amvisëri.

SHËNIMI RËNDËSISHËM:

Shëndeti dhe mirëqenia e pjesëmarrësve në Projekt janë të një rëndësie të madhe. Si rezultat i situatës me pandeminë, Komisioni Evropian ka zgjatur më tej mundësinë për mbajtjen virtuale të misioneve deri në 31 dhjetor të viti 2020.

Kontakt:

Zyra e Këshilltarit të Përhershëm për Binjakëzim

twinning.nbrnm@gmail.com



Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian



Institucione për
implementim



Institucioni përfitues

Komponenti 4. NJOHURI DHE AFTËSI NË ANALIZËN E POLITIKAVE

Në kuadër të tremujorit të katërt të Projektit, në gusht u mbajt një mision virtual nga ana e ekspertit të Bankës Popullore të Rumanisë lidhur me zhvillimin e modelit, si një mision vijues për përmirësimin e aftësive të kërkimit dhe modelimit ekonometrik.

Eksperti rumun, i cili është gjithashtu edhe lider kompetent i një vendi anëtar, punoi bashkë me kolegët nga Drejtoria për Politikë Monetare dhe Kërkime të BPRMV-së në zhvillimin e modelit ekonometrik përmes hapave në vijim:

- Përmbledhje e ekuacioneve të modelit;
- Futja e fërki meve financiare në model - Pozicionimi makroekonomik;
- Përshtatja e modelit për fërkime financiare në modelin më të madh;
- Kalibrimi i parametrave për ekonominë maqedonase;
- Kryerja e një gjendjeje të qëndrueshme të modelit;
- Rregullimi fillestar i modelit për regjimin e kursit fiks të këmbimit;
- Analizë e raportit për funksionet e impuls-reagimit.

Në fund të misionit, materialet e azhuruara (kodet në „Dynare“ dhe „Matlab“ dhe dokumentacioni) u ndanë me kolegët e BPRMV0-së që të mund të vazhdojnë me punën e pavarur. Gjithashtu, u arrit një marrëveshje për misionin e ardhshëm në gjysmën e dytë të shtatorit për mbajtjen e një trajnimit për Vlerësimin Bejzian të modeleve dhe fillimin e procesit të Vlerësimit Bejzian të modelit konkret.

Ky publikim është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbytja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e BPRMV-së dhe në asnjë mënyrë nuk i reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.